



RINDËRTIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE TË SHQIPËRISË PËR TË ARDHMEN



KISHA E T'SHËLBUEDIT, MIRDITË, SHQIPËRI

PROJEKTI "EU4CULTURE"

Tërmeti i nëntorit të vitit 2019 shkaktoi dëme të mëdha në 11 bashki. UNOPS është duke bashkëpunuar me qeverinë e Shqipërisë dhe me Bashkimin Evropian për të lehtësuar rrijetësimin dhe përmirësimin e infrastrukturës ekonomike dhe turistike pas tërmetit të një numri të konsiderueshëm sitesh, muzesh dhe qendrash kulturore me rëndësi kyçe për trashëgiminë kulturore.

FAKTE DHE SHIFRA



SFONDI HISTORIK

E lartësuar mbi komunitetin e vogël të Rubikut, Kisha Françeskane me Manastirin qëndron në krye të një shkëmbi të bardhë, e duket sikur vëzhgon aktivitetet e përditshme të qytetit. Kjo Kishë u themelua fillimisht në vitin 1166 si një nga katër Kuvendet Benediktine në rajonin e Mirditës dhe më pas iu dorëzua Urdhrit Françeskan në Shqipëri diku rreth vitit 1217.

PUNËT E REALIZUARA PËR RUAJTJEN E SAJ

Kisha e T'Shëlbuemit në Rubik lartësohet mbi një shkëmb të thepisur pranë lumit Fan në afërsi të Rubikut. Ajo duket si e gdhendur në gur. Kisha pësoi dëme si pasojë e tërmetit. Çatia nisi të pikonte dhe në suvanë e fasadës së saj u konstatuan shumë plasaritje.

Restaurimi i kryer në sitin e Kishës përfshin riparime rrënjësore të çatisë dhe instalim të shtresave të reja



Funded by
the European Union



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS



hidroizoluese, si edhe një sistem të ri kullimi. Fasada, si pjesa më delikate e godinës, u analizua me detaje. Analiza doli në përfundimin se suvaja më e fundit ishte me bazë çimentoje. Plasaritjet e mëparshme lejonin futjen e lagështirës dhe, për shkak të depërtueshmërisë së çimentos, lagështira qëndronte e bllokuar dhe shkaktonte dëme të mëtejshme duke çuar kështu në ngritjen e suvasë nga muri i gurtë. Nëse ndërhyrja do të kishte vonuar edhe për pak kohë, fasada do të ishte shembur.


Pas një analize të kujdesshme të të dhënave historike, u vendos që të hiqej suvaja e papërshtatshme dhe që muri i gurtë të lihej i ekspozuar. Kjo mori rëndësi të veçantë sidomos në pjesën e absidës, ku u zbulua një strukturë e gurtë mikse e shekullit të 13-të. Përzierja ndërmjet shtufit dhe gurit gëlqeror në strukturën e muraturës krijon një paraqitje estetikisht të këndshme dhe shumë unike të absidës krahasuar me Kishat e tjera të së njëjtës periudhë në Shqipëri.

Më tej dhe në pjesën e saj të brendshme, u kryen punime konsoliduese urgjente e të nevojshme të rrënojave të pikturave murale të shekullit të 13-të, si edhe një përmirësim i instalimeve elektrike dhe i ndriçimit, duke krijuar një atmosferë më komode në brendësi të saj.

Punimet u përmbyllën me riparimin e sistemit të kullimit dhe të trotuarit përreth Kishës, duke përfshirë ndriçimin e ri që shtrihet poshtë kodrinës deri në portën hyrëse kryesore.



Kisha e T'Shëlbuemit të Rubikut është tashmë e hapur për vizitorët dhe besimtarët të cilët historikisht kanë qenë vendas dhe të huaj.



KONTAKT

UNOPS NË SHQIPËRI

Zyrat Qendrore të Kombeve të Bashkuara në Rrugën "Skënderbej, godina "Gurten", kati 3, Tiranë, Shqipëri

www.eu4culture.al

email: info@eu4culture.al

